



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a) dhe (c), 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) dhe (b) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Europiane të Aviacionit (me tej referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja saj e përkohshme në fuqi për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1315/2007 të datës 8 nëntor 2007 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror, e cila ka qenë pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, në zbatim të Marrëveshjes për HPEA, me anë të Rregullores së AAC-së nr. 13/2009 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror, dt. 29 dhjetor 2009,

Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2009, dt. 30 tetor 2009, Rregulloret e AAC-së Nr. 8/2009, Nr. 09/2009, Nr. 10/2009, Nr. 11/2009, të dt. 15 nëntor 2009, Nr. 12/2009, Nr.13/2009, dt. 24 dhjetor 2009, dhe Nr. 12/2010, dt. 18 nëntor 2010, të gjitha të nxjerrura në zbatim të Marrëveshjes për HPEA,

Me qëllim të zbatimit të "Rregullores së Komisionit Europian (EU) nr. 1034/2011 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror dhe ndryshimin e Rregullores (EU) Nr. 691/2010", dt. 17 tetor 2011, në kuadër të rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 6/2012**  
**PËR MBIKËQYRJEN E SIGURISË NË MENAXHIMIN E TRAFIKUT AJROR DHE**  
**SHËRBIMET E NAVIGACIONIT AJROR**

**Neni 1**

Rregullorja Implementuese e Komisionit të Bashkimit European (EU) Nr. 1034/2011, dt. 17 tetor 2011 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror dhe ndryshimin e Rregullores (EU) Nr. 691/2010 (më tej referuar si "Rregullorja e Komisionit") shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

**Neni 2**

2.1 Dispozitat e neneve 1 deri 18, të Rregullores së Komisionit janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

2.2 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, me përjashtim të dispozitave të cilat mbështeten ose referohen në Rregulloren e Komisionit nr. 691/2010, dt. 29 korrik 2010, pas futjes së saj në Shtojcën I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

**Neni 3**

3.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicioneve të përdorura në këtë Rregullore është i përfshirë në nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shprehjet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Europiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit European", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

**Neni 4**

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit, do të përdoret versioni origjinal në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European.

### **Neni 5**

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e AAC-së nr. 13/2009 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror, dt. 24 dhjetor 2009.

### **Neni 6**

Në tekstin e Rregullores nr. 12/2010, dt. 18 nëntor 2010, fshihet referenca në Rregulloren e Komisionit nr. 1315/2007 dhe zëvendësohet me "Rregullorja AAC-së nr. 6/2012, dt. 10 dhjetor 2012.

### **Neni 7**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 21 dhjetor 2012.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtore i Përgjithshëm

## RREGULLORE IMPLEMENTUESE E KOMISIONIT (EU) Nr 1034/2011

të datës 17 tetor 2011

për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror dhe ndryshimin e Rregullores (EU) Nr 691/2010

(Tekst relevant për EEA)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke marrë parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian,

Duke marrë parasysh Rregulloren (EC) Nr 550/2004 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 10 mars 2004, për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në qiellin e vetëm evropian ('Rregullorja e ofrimit të shërbimeve')<sup>1</sup>, dhe në veçanti nenin 4 të saj,Duke marrë parasysh Rregulloren (EC) Nr 551/2004 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 10 mars 2004 për organizimin dhe shfrytëzimin e hapësirës ajrore në qiellin e vetëm evropian ('Rregullore e hapësirës ajrore')<sup>2</sup>, dhe në veçanti nenin 6 të saj,Duke marrë parasysh Rregulloren (EC) Nr 216/2008 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 20 shkurt 2008 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë Evropiane për Siguri në Aviacion, dhe anulimin e Direktivës së Këshillit 91/670/EEC, Rregulloren (EC) Nr 1592/2002 dhe Direktivën 2004/36/EC<sup>3</sup>, dhe në veçanti nenin 8b të saj,

Përderisa:

(1) Sipas Rregullores (EC) Nr 216/2008, Komisioni, me ndihmën e Agjencisë Evropiane për siguri në aviacion ('Agjencia'), kërkohet të miratojë rregullat përkatëse implementuese për të ofruar një grup të kërkesave rregullatore të sigurisë për implementimin e një funksioni të mbikëqyrjes së sigurisë në menaxhimin efektiv të trafikut ajror (ATM). Neni 8b i Rregullores (EC) Nr 216/2008 kërkon që këto rregulla implementuese të hartohen në bazë të rregulloreve të miratuara sipas Neni 5(3) të Rregullores (EC) Nr 549/2004 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 10 mars 2004 që

parashtron kornizën për krijimin e qiellit të vetëm evropian ('Rregullorja kornizë')<sup>4</sup>. Kjo Rregullore bazohet në Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1315/2007 të datës 8 nëntor 2007 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe ndryshimin e Rregullores (EC) Nr 2096/2005<sup>5</sup>.

(2) Ka nevojë që të definohet më mirë roli dhe funksionet e autoriteteve kompetente në bazë të dispozitave të Rregulloreve (EC) Nr 216/2008, (EC) Nr 549/2004, (EC) Nr 550/2004, dhe (EC) Nr 552/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 10 mars 2004 për ndërveprueshmëria- e rrjetit evropian të menaxhimit të trafikut ajror ('Rregullorja e ndërveprueshmërisë')<sup>6</sup>. Këto rregullore përfshijnë kërkesat për sigurinë e shërbimeve të navigacionit ajror. Përderisa ofruesit e shërbimeve janë përgjegjës për ofrimin e sigurtë të shërbimeve të navigacionit ajror, shtetet anëtare (të BE) duhet të sigurojnë mbikëqyrjen efektive përmes autoriteteve kompetente.

(3) Kjo Rregullore nuk duhet të përfshijë operacionet dhe ushtrimet ushtarake, siç është paraparë në nenin 1(2) të Rregullores (EC) Nr 549/2004 dhe nenin 1(2)(c) të Rregullores (EC) Nr 216/2008.

(4) Autoritetet kompetente duhet të bëjnë auditime rregullatore të sigurisë dhe rishikime në pajtim me këtë Rregullore si pjesë e inspektimeve dhe vëzhgimeve të duhura që kërkohen me Rregulloret (EC) Nr 216/2008 dhe (EC) Nr 550/2004.

(5) Autoritetet kompetente duhet të marrin në konsiderim që të përdorin qasjen e mbikëqyrjes së sigurisë në këtë rregullore edhe në fushat tjera të

<sup>4</sup> OJ L 96, 31.3.2004, f. 1.

<sup>5</sup> OJ L 291, 9.11.2007, f. 16.

<sup>6</sup> OJ L 96, 31.3.2004, f. 26.

<sup>1</sup> OJ L 96, 31.3.2004, f. 10.

<sup>2</sup> OJ L 96, 31.3.2004, f. 20.

<sup>3</sup> OJ L 79, 19.3.2008, f. 1.

## SHTOJCË E RREGULLORES NR. 6/2012

18.10.2011 EN

Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian

L-271/5

- mbikëqyrjes sipas nevojës për të kryer mbikëqyrjen efikase dhe koherente.
- (6) Shërbimet e navigacionit ajror, si dhe menaxhimi i rrjedhës së trafikut ajror (ATFM) dhe menaxhimi i hapësirës ajrore (ASM), përdorin sistemet funksionale që mundësojnë menaxhimin e trafikut ajror. Prandaj të gjitha ndryshimet në sistemet funksionale duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së sigurisë.
- (7) Autoritetet kompetente duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme në rast se një sistem ose një element i sistemit nuk i plotëson kërkesat përkatëse. Në këtë kontekst dhe në veçanti nëse duhet të nxirret një direktivë e sigurisë, autoriteti kompetent duhet të marrë në konsiderim që të udhëzohen organet e njoftuara të përfshira në lëshimin e Deklaratës së përmendur në nenin 5 ose 6 të Rregullores (EC) Nr 552/2004 për të kryer hetimet specifike përkitazi me atë sistem teknik.
- (8) Raportimi vjetor i mbikëqyrjes së sigurisë nga autoritetet kompetente duhet të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e mbikëqyrjes së sigurisë. Raportet e tilla duhet të drejtohen te Komisioni, Agjencia dhe shtetet anëtare që kanë emëruar ose themeluar autoritetin kompetent. Për më tepër, raportet vjetore të mbikëqyrjes së sigurisë duhet të përdoren në kontekstin e bashkëpunimit regjional, inspektimet e standardizimit sipas Rregullores (EC) Nr 216/2008 dhe monitorimin e mbikëqyrjes së sigurisë ndërkombëtare. Përmbajtja e raporteve duhet të përfshijë informatat relevante përkitazi me monitorimin e realizimit të sigurisë, respektimin e kërkesave të zbatueshme rregullatore të sigurisë nga organizatat e mbikëqyrura, programin e auditimeve rregullatore të sigurisë, rishikimin e argumenteve të sigurisë, ndryshimet në sistemet funksionale të implementuara nga organizatat e mbikëqyrura në pajtim me procedurat e pranuar nga autoriteti kompetent dhe direktivat e sigurisë të lëshuara nga ai autoritet.
- (9) Sipas nenit 10(1) të Rregullores (EC) Nr 216/2008 dhe nenit 2(4) të Rregullores (EC) Nr 550/2004, autoritetet kompetente duhet të bëjnë organizimet e duhura për bashkëpunimin e afërt me njëri tjetrin për të siguruar mbikëqyrjen adekuate të ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror që ofrojnë shërbime lidhur me hapësirën ajrore që bie nën përgjegjësinë e një shteti anëtar që nuk është ai shtet anëtar që e ka lëshuar certifikatën. Sipas nenit 15 të Rregullores (EC) Nr 216/2008, autoritetet
- kompetente duhet të shkëmbejnë në veçanti informatat e duhura për mbikëqyrjen e sigurisë së organizatave.
- (10) Agjencia më tutje duhet të vlerësojë dispozitat e kësaj Rregulloreje, në veçanti ato që lidhen me mbikëqyrjen e sigurisë së ndryshimeve, dhe të lëshojë një opinion për të miratuar ndryshimet e tilla drejt një qasjeje të sistemit total, duke marrë parasysh integrimin e këtyre dispozitave në strukturën e ardhme të përbashkët rregullatore për sigurinë e aviacionit civil dhe përvojën e fituar nga palët e interesit dhe autoritetet kompetente. Opinioni i agjencisë duhet të synojë më tutje të lehtësojë implementimin e Programit të sigurisë shtetërore (SSP) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) brenda BE-së si pjesë e kësaj qasjeje të sistemit total.
- (11) Realizimi i sigurtë i disa funksioneve të rrjetit të vendosura sipas Rregullores (EC) Nr 551/2004 kërkon që njësi e përfshirë t'i nënshtrohet disa kërkesave të sigurisë. Këto kërkesa, që kanë për synim të sigurojnë që ajo njësi ose organizatë funksionon në mënyrë të sigurtë, janë parashtruar në Rregulloren e Komisionit (EU) Nr 677/2011 të datës 7 korrik 2011 që parashtron rregullat e detajuara për implementimin e menaxhimit të funksioneve të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror (ATM) dhe ndryshimin e Rregullores (EU) Nr 691/2010<sup>1</sup>. Këto janë kërkesat e sigurisë së organizatës që janë shumë të ngjashme me ato kërkesa të përgjithshme që janë paraqitur në Komisionin që Implementon Rregulloren (EU) Nr 1035/2011<sup>2</sup>, por janë përshtatur me përgjegjësitë e sigurisë së funksioneve të rrjetit. Për të përkrahur një qasje të sistemit total për rregullimin e sigurisë në fushën e aviacionit civil, ekzekutimi i këtyre kërkesave duhet të mbikëqyret në të njëjtën mënyrë siç mbikëqyren ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror.
- (12) Në rekomandimet e tij të korrikut të vitit 2007, Grupi i Nivelit të Lartë për kornizën rregullatore Evropiane të ardhme të aviacionit theksoi nevojën për të ndarë mbikëqyrjen rregullatore nga ofrimi i shërbimeve ose funksioneve. Në përputhje me këtë parim, neni 6 i Rregullores (EC) Nr 551/2004 parashikon se subjekti i emëruar për të kryer funksionet e rrjetit duhet t'i nënshtrohet marrëveshjeve përkatëse mbikëqyrëse. Pasi që Agjencia tashmë kryen funksionin mbikëqyrës të pavarur të sigurisë së ofruesve pan-evropianë të ATM/ANS në përputhje me nenin 22a të Rregullores (EC) Nr 216/2008, do të jetë në përputhje të plotë me

<sup>1</sup> OJ L 185, 15.7.2011, f. 1.

<sup>2</sup> Shih faqe 23 të kësaj Gazete Zyrtare.

politikën Evropiane të sigurisë së aviacionit që t'ia besojë mbështetjen e Komisionit në kryerjen e detyrave të njëjta në lidhje me funksionet e rrjetit evropian.

(13) Rregullorja (EC) Nr 1315/2007 për këtë arsye duhet të shfuqizohet.

(14) Rregullorja e Komisionit (EU) Nr 691/2010 e datës 29 korrik 2010 që paraqet një skemë të performancës për shërbimet e navigacionit ajror dhe funksionet e rrjetit dhe ndryshon Rregulloren (EC) Nr 2096/2005<sup>1</sup> duhet të ndryshohet në mënyrë që të përshtatet me këtë Rregullore.

(15) Masat e parapara në këtë Rregullore janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Qiellit të Vetëm,

#### MIRATOI KËTË RREGULLORE:

##### *Neni 1*

#### **Lënda dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore përcakton kërkesat që duhet të zbatohen për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së sigurisë nga autoritetet kompetente në lidhje me shërbimet e navigacionit ajror, menaxhimin e rrjedhës së trafikut ajror (ATFM), menaxhimin e hapësirës ajrore (ASM) për trafikun ajror të përgjithshëm dhe funksionet e tjera të rrjetit.

2. Kjo Rregullore duhet të zbatohet për aktivitetet e autoriteteve kompetente dhe subjekteve të kualifikuar që veprojnë në emër të tyre në lidhje me mbikëqyrjen e sigurisë së shërbimeve të navigacionit ajror, ATFM, ASM dhe funksionet e tjera të rrjetit.

##### *Neni 2*

#### **Definicionet**

Për qëllim të kësaj rregulloreje zbatohen definicionet në nenin 2 të Rregullores (EC) Nr 549/2004 dhe nenin 3 të Rregullores (EC) Nr 216/2008. Megjithatë definicioni i 'certifikatës' në nenin 2(15) të Rregullores (EC) Nr 549/2004 nuk vlen.

Vlejnë edhe këto definicione:

(1) 'veprim korrektues' do të thotë veprim për të eliminuar shkakun e një jo-konformiteti të zbuluar;

(2) 'sistem funksional' do të thotë një kombinim i sistemeve, procedurave dhe burimeve njerëzore të organizuara për të kryer një funksion brenda kontekstit të ATM;

(3) "menaxher rrjeti" do të thotë organi kompetent i paanshëm të cilit në pajtim me nenin 6 (2) ose (6) të Rregullores (EC) Nr 551/2004 i është besuar për të kryer detyrat e përshkruara në këtë nen dhe këtë rregullore;

(4) "funksionet e rrjetit" do të thotë funksionet specifike të përshkruara në nenin 6 të Rregullores (EC) Nr 551/2004;

(5) "organizata" do të thotë ose një ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror ose një subjekt që ofron ATFM ose ASM ose funksione tjera të rrjetit;

(6) "procesi" do të thotë një grup i aktiviteteve të ndërlidhura ose që bashkëveprojnë dhe që transformon inputet në rezultate;

(7) "argumenti i sigurisë" do të thotë demonstrimi dhe dëshmitë se një ndryshim i propozuar në një sistem funksional mund të zbatohet brenda caqeve apo standardeve të përcaktuara me anë të kuadrit ekzistues rregullator në përputhje me kërkesat e sigurisë rregullatore;

(8) "direktiva e sigurisë" do të thotë dokumenti i lëshuar ose i miratuar nga një autoritet kompetent i cili urdhëron veprimet që duhet të kryhen në një sistem funksional për të rivendosur sigurinë, kur dëshmitë tregojnë se siguria e aviacionit mund të rrezikohet përndryshe;

(9) "objektivi i sigurisë" do të thotë një deklaratë cilësore apo sasiore që përcakton frekuencën maksimale ose probabilitetin me të cilin mund të pritët të ndodhë një rrezik;

(10) "auditimi rregullator i sigurisë" nënkupton një ekzaminim sistematik dhe të pavarur të kryer nga një autoritet kompetent ose në emër të tij, për të përcaktuar nëse aranzhimet e plota të sigurisë ose elementet e tyre, në lidhje me proceset dhe rezultatet e tyre, produktet ose shërbimet, janë në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë dhe nëse ato janë zbatuar efektivisht dhe janë të duhura për të arritur rezultatet e pritura;

<sup>1</sup> OJ L 201, 3.8.2010, f. 1.

(11) "kërkesat rregullatore të sigurisë" do të thotë kërkesat e vendosura nga Bashkimi Evropian ose rregulloret kombëtare për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror ose funksioneve ATFM dhe ASM apo funksione të tjera të rrjetit, si dhe në lidhje me kompetencën teknike dhe operacionale dhe përshtatshmërinë për të ofruar këto shërbime dhe funksione, menaxhimin e sigurisë, si dhe sistemet, përbërësit e tyre dhe procedurat përkatëse;

(12) "kërkesa të sigurisë" do të thotë një minimizim i rrezikut, i përcaktuar nga strategjia e minimizimit të rrezikut që arrin një objektiv të caktuar të sigurisë, duke përfshirë kërkesat organizative, operative, procedurale, funksionale, të performancës dhe kërkesat e ndërveprimit ose karakteristikat mjedisore;

(13) "verifikimi" do të thotë konfirmimi nëpërmjet ofrimit të provave objektive që kërkesat e specifikuar janë plotësuar;

(14) "ATM/ANS pan-Evropiane" do të thotë një aktivitet që është projektuar dhe krijuar për përdoruesit brenda shumicës ose të gjitha Shteteve Anëtare (të BE) dhe që gjithashtu mund të shtrihet përtej hapësirës ajrore të territorit në të cilin zbatohet Traktati.

#### Neni 3

##### **Autoritetet kompetente për mbikëqyrje**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje dhe pa paragjykuar njohjen e ndërsjellë të certifikatave të ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në përputhje me nenin 7 (8) të Rregullores (EC) Nr 550/2004 dhe nenit 11 të Rregullores (EC) Nr 216/2008, autoritetet kompetente për mbikëqyrje do të jenë:

(a) për organizatat që kanë vendin e tyre kryesor të veprimit dhe, nëse kanë, zyrën e regjistruar të vendosur në një Shtet Anëtar, ndërsa ofrojnë shërbime të navigacionit ajror në territorin e atij Shteti Anëtar, autoriteti kombëtar mbikëqyrës i emëruar ose themeluar nga ai Shtet Anëtar;

(b) për organizatat për të cilat, sipas marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Shteteve Anëtare në përputhje me nenin 2 të Rregullores (EC) Nr 550/2004, përgjegjësitë për mbikëqyrjen e sigurisë janë ndarë ndryshe nga pika (a), autoritetet kompetente të emëruara ose të themeluara sipas këtyre marrëveshjeve. Këto marrëveshje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 2 (3) deri (6) të Rregullores (EC) Nr 550/2004;

(c) për organizatat që ofrojnë ATM/shërbime të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të territorit në të cilin zbatohet Traktati dhe që kanë vendin e tyre kryesor të veprimit dhe, nëse kanë, zyrën e tyre të regjistruar të vendosur jashtë territorit që i nënshtrohet dispozitave të Traktatit, Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit ("Agjencia");

(d) për organizatat që ofrojnë ATM/ANS pan-Evropiane, si dhe për të gjitha funksionet e tjera të rrjetit në hapësirën ajrore të territorit në të cilin zbatohet Traktati, Agjencia.

#### Neni 4

##### **Funksioni i mbikëqyrjes së sigurisë**

1. Autoritetet kompetente duhet të ushtrojnë mbikëqyrjen e sigurisë si pjesë e mbikëqyrjes së kërkesave të zbatueshme për shërbimet e navigacionit ajror, si dhe për ATFM, ASM dhe funksionet e tjera të rrjetit, në mënyrë që të monitorojnë kryerjen e sigurt të këtyre veprimtarive dhe të verifikojnë se janë plotësuar kërkesat rregullatore të sigurisë në fuqi dhe marrëveshjet e tyre të implementimit.

2. Kur lidhet një marrëveshje për mbikëqyrjen e organizatave aktive në blloqet e hapësirës ajrore funksionale që shtrihen në të gjithë hapësirën ajrore që është në përgjegjësinë e më shumë se një Shteti Anëtar ose në raste të ofrimit të shërbimeve ndër-kufitare, Shtetet Anëtare në fjalë duhet të identifikojnë dhe të ndajnë përgjegjësitë për mbikëqyrjen e sigurisë në një mënyrë që siguron se:

(a) pikat e veçanta të përgjegjësisë ekzistojnë për të zbatuar çdo dispozitë të kësaj Rregulloreje;

(b) Shtetet Anëtare mund t'i shohin mekanizmat e mbikëqyrjes të sigurisë dhe rezultatet e tyre;

(c) shkëmbimi i informacionit të rëndësishëm është siguruar ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoritetit certifikues.

Shtetet Anëtare duhet të rishikojnë rregullisht marrëveshjen dhe zbatimin e saj në praktikë në veçanti përkitazi me performancën e arritur të sigurisë.

3. Kur lidhet një marrëveshje për mbikëqyrjen e organizatave aktive në blloqet e hapësirës ajrore funksionale ose në aktivitetet ndër-kufitare në të cilat Agjencia është autoriteti kompetent për të paktën një nga organizatat në përputhje me nenin 3 (b), Shtetet Anëtare

përkatëse do të koordinohen me Agjencinë për të siguruar që pikat (a), (b) dhe (c) të paragrafit 2 janë përmbushur.

*Neni 5*

**Monitorimi i performancës së sigurisë**

1. Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë monitorimin e rregullt dhe vlerësimin e niveleve të sigurisë të arritura në mënyrë që të përcaktohet nëse ato përputhen me kërkesat rregullatore të sigurisë të zbatueshme në blloqet e hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e tyre.

2. Autoritetet kompetente duhet të përdorin rezultatet e monitorimit të sigurisë, në veçanti për të përcaktuar fushat në të cilat verifikimi i pajtueshmërisë me kërkesat rregullatore të sigurisë është i nevojshëm si çështje me prioritet.

*Neni 6*

**Verifikimi i respektimit të kërkesave rregullatore të sigurisë**

1. Autoritetet kompetente duhet të krijojnë një proces për të verifikuar:

(a) pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore të sigurisë në fuqi para lëshimit ose vazhimit të certifikatës së nevojshme për të ofruar shërbime të navigacionit ajror, duke përfshirë kushtet e sigurisë të lidhura me të;

(b) pajtueshmërinë me obligimet eventuale të sigurisë në aktin e caktimit të lëshuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores (EC) Nr 550/2004;

(c) pajtueshmërinë e vazhdueshme të organizatave me kërkesat rregullatore të sigurisë në fuqi;

(d) zbatimin e objektivave të sigurisë, kërkesave të sigurisë dhe kushteve të tjera të sigurisë të identifikuara në:

(i) deklaratat e verifikimit të sistemeve, duke përfshirë çdo deklaratë përkatëse të konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorimin e përbërësve të sistemeve, të lëshuara në përputhje me Rregulloren (EC) Nr 552/2004;

(ii) vlerësimin e rrezikut dhe procedurat e minimizimit të rrezikut që parashihen në kërkesat rregullatore të sigurisë në fuqi për shërbimet e navigacionit ajror, ATFM, ASM dhe Menaxherin e Rrjetit;

(d) zbatimin e direktivave të sigurisë.

2. Procesi i përmendur në paragrafin 1 duhet të:

(a) bazohet në procedurat e dokumentuara;

(b) të vërtetohet me dokumentacion të dhënë posaçërisht për të ofruar udhëzime për personelin e mbikëqyrjes së sigurisë për të kryer funksionet e tyre;

(c) të japë për organizatat në fjalë tregues të rezultateve të aktivitetit të mbikëqyrjes së sigurisë;

(d) të bazohet në auditimet rregullatore të sigurisë dhe rishikimet e kryera në përputhje me nenet 7, 9 dhe 10;

(d) të japë për autoritetet kompetente provat e nevojshme për të përkrahur veprimet e mëtejshme, duke përfshirë edhe masat e parapara me nenin 9 të Rregullores (EC) Nr 549/2004, nenin 7 (7) të Rregullores (EC) Nr 550/2004 dhe nenet 10, 25 dhe 68 të Rregullores (EC) Nr 216/2008 në situatat kur nuk janë duke u zbatuar kërkesat rregullatore të sigurisë.

*Neni 7*

**Auditimet rregullatore të sigurisë**

1. Autoritetet kompetente, apo subjektet e kualifikuara si të deleguara nga ana e tyre do të kryejnë auditime rregullatore të sigurisë.

2. Auditimet rregullatore të sigurisë të përmendura në paragrafin 1 duhet:

(a) japin për autoritetet kompetente dëshmi të zbatimit të kërkesave rregullatore të sigurisë në fuqi dhe të marrëveshjeve të implementimit duke vlerësuar nevojën për përmirësim apo veprim korrigjues;

(b) të jenë të pavarura nga aktivitetet e auditimit të brendshëm të ndërmarra nga organizata në fjalë, si pjesë e sistemeve të veta të sigurisë apo menaxhimit të cilësisë;

(c) të kryhen nga auditorë të kualifikuar në përputhje me kërkesat e Nenit 12;

(d) të zbatohen për marrëveshjet e plota të implementimit apo elementet e tyre, si dhe për proceset, produktet ose shërbimet;

(e) të përcaktojnë nëse:



(i) marrëveshjet e implementimit janë në përputhje me kërkesat rregullatore të sigurisë;

(ii) veprimet e ndërmarra janë në pajtueshmëri me marrëveshjet e implementimit;

(iii) rezultatet e veprimeve të ndërmarra përputhen me rezultatet e pritura nga marrëveshjet e implementimit;

(f) të çojnë në korrigjimin e mos-pajtueshmërive të identifikuar në përputhje me nenin 8.

3. Në kuadër të programit të inspektimit që kërkohet me nenin 8 të Rregullores së Implementimit (EU) Nr 1035/2011, autoritetet kompetente duhet të krijojnë dhe azhurnojnë të paktën çdo vit një program të auditimeve rregullatore të sigurisë në mënyrë që:

(a) të mbulojnë të gjitha fushat me interes potencial të sigurisë, me përqendrim në ato fusha ku janë identifikuar problemet;

(b) të mbulojnë të gjitha organizatat, shërbimet dhe funksionet e rrjetit që veprojnë nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent;

(c) të sigurojnë që auditimet kryhen në mënyrë proporcionale me nivelin e rrezikut që vjen nga aktivitetet e organizatave;

(d) të sigurojnë se janë kryer auditime të mjaftueshme gjatë një periudhe prej 2 vitesh për të kontrolluar pajtueshmërinë e të gjitha këtyre organizatave me kërkesat rregullatore të sigurisë të zbatueshme në të gjitha fushat përkatëse të sistemit funksional;

(e) të sigurojnë përcjelljen e zbatimit të veprimeve korrigjuese.

4. Autoritetet kompetente mund të vendosin për të modifikuar fushëveprimin e auditimeve të planifikuara më parë dhe të përfshijnë auditime shtesë, kudo që lind nevoja.

5. Autoritetet kompetente duhet të vendosin se cilat marrëveshje, elemente, shërbime, funksione, produkte, vende fizike dhe aktivitete duhet të auditohen brenda një afati kohor të specifikuar.

6. Rezultatet e auditimit dhe mos-pajtueshmëritë e identifikuar duhet të dokumentohen. Këto të fundit duhet të përkrahen me dëshmi, dhe të identifikohen sa i përket kërkesave rregullatore të sigurisë në fuqi dhe marrëveshjeve të tyre të implementimit kundrejt të cilave është kryer auditimi.

7. Duhet të hartohet një raport i auditimit, duke përfshirë detajet e rasteve kur ka pasur mos-pajtueshmëri.

#### Neni 8

##### Veprimet korrigjuese

1. Autoritetet kompetente duhet të komunikojnë të gjeturat e auditimit te organizatat e audituara dhe njëkohësisht të kërkojnë veprime korrigjuese për të trajtuar e identifikuar pa paragjykim ndaj ndonjë veprimi shtesë që kërkohet me kërkesat rregullatore të sigurisë në fuqi.

2. Organizatat e audituara duhet të përcaktojnë veprimet korrigjuese që konsiderohen të nevojshme për të korrigjuar mos-pajtueshmëritë dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

3. Autoritetet kompetente duhet të vlerësojnë veprimet korrigjuese, si dhe zbatimin e tyre siç përcaktohet nga organizatat e audituara dhe t'i pranojnë ato, nëse vlerësimi konstaton se janë të mjaftueshme për të trajtuar mos-pajtueshmëritë.

4. Organizatat e audituara duhet të fillojnë veprimet korrigjuese të pranuar nga autoritetet kompetente. Këto veprime korrigjuese dhe procesi i mëvonshëm i përcjelljes së tyre duhet të përfundojnë brenda afatit të pranuar nga autoritetet kompetente.

#### Neni 9

##### Mbikëqyrja e sigurisë së ndryshimeve në sistemet funksionale

1. Organizatat duhet të përdorin vetëm procedurat e pranuar nga autoriteti kompetent përkatës, kur vendosin nëse do të bëjnë një ndryshim në sistemet e tyre funksionale që lidhet me sigurinë. Në rast të ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror dhe të komunikimit, navigacionit apo ofruesve të shërbimeve të mbikëqyrjes, autoriteti përkatës kompetent duhet t'i pranojë këto procedura në kuadrin e Rregullores Implementuese (EU) Nr 1035/2011.

2. Organizatat duhet ta njoftojnë autoritetin kompetent përkatës për të gjitha ndryshimet e planifikuara që lidhen me sigurinë. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente duhet

të vendosin procedurat e duhura administrative, në përputhje me ligjin kombëtar.

3. Përveç nëse vlen Neni 10, organizatat mund të zbatojnë ndryshimet e njoftuara pas procedurave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

*Neni 10*

**Procedura e rishikimit të ndryshimeve të propozuara**

1. Autoritetet kompetente duhet të shqyrtojnë argumentet e sigurisë që lidhen me sistemet e reja funksionale apo ndryshimet në sistemet ekzistuese funksionale të propozuara nga një organizatë kur:

(a) vlerësimi i kryer në pajtim me Aneksin II, pika 3.2.4 të Rregullores së Implementimit (EU) Nr 1035/2011 përcakton klasën e seriozitetit 1 ose klasën e seriozitetit 2 për efektet e mundshme të rreziqeve të identifikuar ose

(b) zbatimi i ndryshimeve kërkon futjen e standardeve të reja të aviacionit.

Kur autoritetet kompetente përcaktojnë nevojën për një shqyrtim në situata të ndryshme nga ato të përmendura në pikat (a) dhe (b), ata duhet ta njoftojnë organizatën që do të ndërmarrin një rishikim të sigurisë së ndryshimeve të njoftuara.

2. Shqyrtimet duhet të kryhen në mënyrë proporcionale me nivelin e rrezikut që vjen nga sistemet e reja funksionale ose nga ndryshimet e propozuara në sistemet ekzistuese funksionale.

Shqyrtimet duhet:

(a) të përdorin procedura të dokumentuara;

(b) të përkrahen me dokumentacion të përgatitur posaçërisht për të dhënë udhëzime për personelin e mbikëqyrjes së sigurisë për të kryer funksionet e tyre;

(c) të marrin në konsideratë objektivat e sigurisë, kërkesat e sigurisë dhe kushte të tjera të sigurisë të lidhura me ndryshimet që po shqyrtohen, të identifikuar në:

(i) deklaratat e verifikimit të sistemeve të përmendura në nenin 6 të Rregullores (EC) Nr 552/2004;

(ii) deklaratat e konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorim nga përbërësit e sistemeve të përmendura në nenin 5 të Rregullores (EC) Nr 552/2004; ose

(iii) dokumentacionin e vlerësimit dhe minimizimit të rrezikut të krijuar në pajtim me kërkesat rregullatore të zbatueshme të sigurisë;

(d) të identifikojnë kushte shtesë të sigurisë që lidhen me zbatimin e ndryshimeve të nevojshme, nëse është e nevojshme;

(e) të vlerësojnë pranueshmërinë e argumenteve të paraqitura të sigurisë, duke marrë parasysh:

(i) identifikimin e rreziqeve;

(ii) konsistencën e ndarjes së klasave të seriozitetit të rrezikut;

(iii) vlefshmërinë e objektivave të sigurisë;

(iv) vlefshmërinë, efektivitetin dhe mundësinë e realizimit të kërkesave të sigurisë dhe kushteve të tjera të identifikuar të sigurisë;

(v) demonstrimin që objektivat e sigurisë, kërkesat e sigurisë dhe kushtet tjera të sigurisë janë përmbushur vazhdimisht;

(vi) demonstrimin që procesi i përdorur për të prodhuar argumentet e sigurisë i plotëson kërkesat rregullatore të zbatueshme të sigurisë;

(f) të verifikojnë proceset e përdorura nga organizatat për të prodhuar argumentet e sigurisë në lidhje me sistemin e ri funksional ose ndryshimet në sistemet ekzistuese funksionale që janë duke u shqyrtuar;

(g) të identifikojnë nevojën për verifikimin e pajtueshmërisë në vazhdimësi;

(h) të përfshijnë aktivitete të nevojshme të koordinimit me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurisë së fluturimit dhe operacioneve të fluturimit;

(i) të sigurojnë njoftimin e pranimit, me kushtet nëse zbatohen, ose mospranimit, me arsyet që e përkrahen atë, të ndryshimit që është duke u shqyrtuar.

3. Futja në funksion e ndryshimeve që janë duke u shqyrtuar i nënshtrohet pranimit nga ana e autoriteteve kompetente.

**Subjektet e kualifikuara**

1. Kur një autoritet kompetent vendos të delegojë te një subjekt i kualifikuar kryerjen e auditimeve rregullatore të sigurisë apo shqyrtimeve në përputhje me këtë Rregullore, ai duhet të sigurojë që kriteret e përdorura për të zgjedhur një subjekt në mesin e atyre të kualifikuar në përputhje me nenin 3 të Rregullores (EC) Nr 550/2004 dhe nenit 13 të Rregullores (EC) Nr 216/2008 përfshijnë të mëposhtmet:

(a) subjekti i kualifikuar ka eksperiencë paraprake në vlerësimin e sigurisë në subjektet e aviacionit;

(b) subjekti i kualifikuar nuk është i përfshirë në të njëjtën kohë në aktivitete të brendshme në kuadër të sistemeve të sigurisë apo menaxhimit të cilësisë të organizatës në fjalë;

(c) i tërë personeli që merret me kryerjen e auditimeve rregullatore të sigurisë apo shqyrtimeve është i trajnuar në mënyrë adekuate dhe i kualifikuar dhe i përmbush kriteret e kualifikimit të nenit 12 (3) të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti i kualifikuar duhet të pranojë mundësinë që të auditohet nga autoriteti kompetent apo ndonjë organ që vepron në emër të tij.

3. Autoritetet kompetente duhet të mbajnë një regjistër të subjekteve të kualifikuara të thirrura për të kryer auditime rregullatore të sigurisë apo shqyrtime në emër të tyre. Regjistrat e tilla duhet të dokumentojnë respektimin e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1.

*Neni 12***Aftësitë për mbikëqyrje të sigurisë**

1. Shtetet Anëtare dhe Komisioni duhet të sigurojnë që autoritetet kompetente kanë aftësinë e nevojshme për të siguruar mbikëqyrjen e sigurisë të të gjitha organizatave që veprojnë nën mbikëqyrjen e tyre, duke përfshirë resurse të mjaftueshme për të kryer veprimet e identifikuar në këtë Rregullore.

2. Autoritetet kompetente duhet të hartojnë dhe azhurnojnë çdo 2 vjet një vlerësim të burimeve njerëzore të nevojshme për të kryer funksionet mbikëqyrëse të sigurisë, bazuar në analizën e proceseve të kërkuara me këtë Rregullore dhe zbatimin e tyre.

3. Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që të gjithë personat e përfshirë në aktivitete të mbikëqyrjes së

sigurisë janë kompetentë për të kryer funksionin e kërkuar. Në këtë drejtim ata duhet të:

(a) të përcaktojnë dhe dokumentojnë arsimin, trajnimin, njohuritë teknike dhe operative, përvojën dhe kualifikimet relevante për detyrat e secilit pozicion të përfshirë në aktivitetet e mbikëqyrjes së sigurisë brenda strukturës së tyre;

(b) të sigurojnë trajnime specifike për ata që janë përfshirë në aktivitetet e mbikëqyrjes së sigurisë brenda strukturës së tyre;

(c) të sigurojnë që personeli i caktuar për të kryer auditime rregullatore të sigurisë, duke përfshirë personelin e auditimit nga subjektet e kualifikuara, i përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kompetent. Kriteret duhet të trajtojnë:

(i) njohuritë dhe të kuptuarit e kërkesave të lidhura me shërbimet e navigacionit ajror, ATFM, ASM dhe funksionet tjera të rrjetit kundrejt të cilave mund të kryhen auditimet rregullatore të sigurisë;

(ii) përdorimin e teknikave të vlerësimit;

(iii) aftësitë e nevojshme për menaxhimin e një auditimi;

(iv) demonstrimin e kompetencës së auditorëve përmes vlerësimit ose mjeteve të tjera të pranueshme.

*Neni 13***Direktivat e sigurisë**

1. Autoritetet kompetente duhet të nxjerrin një direktivë të sigurisë, kur ata kanë përcaktuar ekzistencën e një gjendjeje të pasigurt në një sistem funksional që kërkon veprim të menjëhershëm.

2. Direktivat e sigurisë duhet të përcillen te organizatat në fjalë dhe të përmbajnë, në minimum, informacionin e mëposhtëm:

(a) identifikimin e gjendjes së pasigurt;

(b) identifikimin e sistemit të prekur funksional;

(c) veprimet e nevojshme dhe arsyeshmërinë e tyre;

(d) afatin kohor për zbatimin e veprimeve të kërkuara me direktivën e sigurisë;

(e) datën e hyrjes së saj në fuqi.

3. Autoritetet kompetente duhet të dërgojnë një kopje të direktivës së sigurisë te Agjencia dhe autoritetet tjera kompetente të interesuara, në veçanti ato që janë përfshirë në mbikëqyrjen e sigurisë së sistemit funksional, si dhe te Komisioni.

4. Autoritetet kompetente duhet të verifikojnë pajtueshmërinë me direktivat e sigurisë në fuqi.

#### *Neni 14*

##### **Regjistrat e mbikëqyrjes së sigurisë**

Autoritetet kompetente duhet të mbajnë dhe të mirëmbajnë qasjen në të dhënat e duhura në lidhje me proceset e tyre të mbikëqyrjes së sigurisë, duke përfshirë raportet e të gjitha auditimeve rregullatore të sigurisë dhe regjistrat e tjera të lidhura me sigurinë për certifikatat, emërtimet, mbikëqyrjen e sigurisë së ndryshimeve, direktivat e sigurisë dhe shfrytëzimin e subjekteve të kualifikuara.

#### *Neni 15*

##### **Raportimi i mbikëqyrjes së sigurisë**

1. Autoritetet kompetente duhet të raportojnë çdo vit për veprimet e mbikëqyrjes të sigurisë në pajtim me këtë Rregullore. Raporti vjetor i mbikëqyrjes së sigurisë duhet të përfshijë edhe informacionin mbi të mëposhtmet:

(a) struktura organizative dhe procedurat e autoritetit kompetent;

(b) hapësirën ajrore që bie nën përgjegjësinë e Shteteve Anëtare që e kanë themeluar ose emëruar autoritetin kompetent, nëse vlen, dhe organizatat që bien nën mbikëqyrjen e këtij autoriteti kompetent;

(c) subjektet e kualifikuara që janë thirrur për të kryer auditime rregullatore të sigurisë;

(d) nivelet ekzistuese të resurseve të autoritetit kompetent;

(e) çështjet e sigurisë të identifikuara nëpërmjet proceseve të mbikëqyrjes së sigurisë të kryera nga autoriteti kompetent.

2. Shtetet Anëtare duhet të përdorin raportet e hartuara nga autoritetet e tyre kompetente, kur dorëzojnë raportet e tyre vjetore te Komisioni, siç kërkohet me nenin 12 të Rregullores (EC) Nr 549/2004.

Raportet vjetore të mbikëqyrjes së sigurisë duhet të vihen në dispozicion të Shteteve Anëtare të interesuara në rastin e blloqeve të hapësirës ajrore funksionale, të Agjencisë dhe të programeve apo aktiviteteve të kryera në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të pranuar për të monitoruar apo audituar zbatimin e mbikëqyrjes së sigurisë së shërbimeve të navigacionit ajror, ATFM, ASM dhe funksioneve të tjera të rrjetit.

#### *Neni 16*

##### **Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente**

Autoritetet kompetente duhet të bëjnë marrëveshje për bashkëpunim të afërt në përputhje me nenet 10 dhe 15 të Rregullores (EC) Nr 216/2008 dhe nenin 2 (4) të Rregullores (EC) Nr 550/2004 dhe shkëmbimin e informacionit të duhur për të siguruar mbikëqyrjen e sigurisë së të gjitha organizatave që ofrojnë shërbime ose funksione ndërkufitare.

#### *Neni 17*

##### **Dispozitat kalimtare**

1. Veprimet e filluara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje në bazë të Rregullores (EC) Nr 1315/2007 duhet të menaxhohen në përputhje me këtë Rregullore.

2. Autoriteti i një shteti anëtar i cili ka pasur përgjegjësinë për mbikëqyrjen e sigurisë së organizatave për të cilat Agjencia është autoriteti kompetent në pajtim me nenin 3 do të transferojë te Agjencia funksionin e mbikëqyrjes së sigurisë së këtyre organizatave 12 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, përveç në rastin e mbikëqyrjes së sigurisë së Menaxherit të Rrjetit, ku transferi, nëse ka, te Komisioni, i ndihmuar nga Agjencia, do të bëhet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

#### *Neni 18*

##### **Shfuqizimi**

Rregullorja (EC) Nr 1315/2007 shfuqizohet.

## SHTOJCË E RREGULLORES NR. 6/2012

18.10.2011 EN

Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian

L-271/13

*Neni 19*

### **Ndryshimet në Rregulloren (EU) Nr 691/2010**

Në Aneksin IV të Rregullores (EU) Nr 691/2010, pika 1.1 (d) zëvendësohet si vijon:

'(e) raportet e sigurisë NSA siç përmenden në nenet 7, 8 dhe 14 të Rregullores së Implementimit të Komisionit (EU) Nr 1034/2011 (\*) si dhe raportet NSA për zgjidhjen e mangësive të identifikuara të sigurisë që janë objekt i planeve korrigjuese të veprimit;

(\*) OJ L 271, 18.10.2011, f. 15.'

*Neni 20*

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 20 ditë pas botimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Kjo Rregullore është obliguese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

E punuar në Bruksel, 17 tetor 2011.

*Për Komisionin*

*Presidenti*

José Manuel BARROSO

---